



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E TE ARDHURAVE, PRONAVE PUBLIKE, LEJEVE DHE LICENCAVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Kukës me, 16 . 12 .2021

## PROJEKT - VENDIM

Nr. 70 Datë 16 . 12 .2021

### PËR

## MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KUKËS PËR VITIN 2022

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015, te miratuar me date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.3, 54/f, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne RSH",ligjin Nr.115/2014, te miratuar me date 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësite të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 4,5,7,10-20,ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006," "Për Sistemin e Taksave Vendore"(i ndryshuar),nenet 4,5,6,7,9,10,14,20-24,35,ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),nenet 2,6,7,10,68,69,76,106, ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat"(i ndryshuar), ligjin Nr.131/2015, te miratuar me datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ligjin Nr.10081,datë 23.02.2009 "Për Liçencat,Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), ligjin Nr.107/2014, te miratuar me datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e Territorit"(i ndryshuar),nenet 5,12,13,27,46,ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje"(i ndryshuar),ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), ligjin 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", ligjin Nr.9385,date 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor"(i ndryshuar),ligjin Nr.9693,datë19.03.2007 "Për Fondin Kullor" (i ndryshuar), ligjin 8519 datë 30.07.1999 "Për ujtjen dhe kullimin", i ndryshuar, ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"(i ndryshuar),ligjin Nr.119/2014, te miratuar me date 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"(i ndryshuar),ligjin Nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",VKM Nr.408, datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar),VKM Nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa",(i ndryshuar),udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013"Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël",(i ndryshuar), udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),pas relacionit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ku përfshihen edhe propozimet me shkrim të bëra nga drejtoritë e tjera në Bashki sipas funksioneve që ato kanë, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Kukes te,

**MIRATOJE:**

1. Taksat dhe tarifat vendore per Bashkine Kukës per vitin 2022, bashkangjitur ketij P/vendimi



**Konc.** Sh. Dogjani \_\_\_\_\_

**Ligjshmeria:** F. Spahia \_\_\_\_\_

**Sekretari:** E. Ramallari \_\_\_\_\_